



Aplikimi jurisprudencës së GJEDNJ-së në Kosovë

FOL



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

INPO
Iniciativa për progres

Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Florian Smajli

Ekipi i monitoruesve: Deona Kamberaj, Elda Veseli, Elza Tullari, Flamur Kabashi, Viona Bunjaku dhe Zamira Krasniqi

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi, Lëvizjes FOL, apo Iniciativës për Progres.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e autorëve dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës Gjermane në Kosovë.

Implemented by:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

FOL



Supported by:



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Pristina

Maj, 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive	8
2. Metodologjia	10
3. Pozita e jurisprudencës së GjEDNj-së në rendin juridik kosovar	12
4. Rëndësia e zbatimit të jurisprudencës së GjEDNj-së	13
5. Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nga gjykatat	13
6. Cilësia e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së	16
7. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm	18
8. Barazia e armëve	23
a. Propozimi i provave	23
b. Shqyrtimi i pretendimeve	26
c. Ndihma juridike falas	28
9. Mbrojtja e pronës	30
a. Në procedurë penale	30
b. Në procedurë civile	32
10. Publiciteti i gjykimeve	33
11. Akustika në sallat e gjykimit	35
12. Të drejtat gjuhësore	35
13. Vendimmarrja e institucioneve të pavarura	37
14. Prezumimi i pafajësisë	39
15. Përfundime	40
16. Rekomandime	43

Lista e shkurtesave

GJEDNj	-	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	-	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjK	-	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
KGjK	-	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	-	Këshilli Prokurorial i Kosovës
AIP	-	Agjencia për Informim dhe Privatësi
KPMShCK	-	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
KPM	-	Komisioni i Pavarur për Media
OSHP	-	Organi Shqyrtues i Prokurimit
AK	-	Autoriteti i Konkurrencës
ANJF	-	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Përmbledhje ekzekutive

Në rendin juridik Kosovar, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore aplikohen sipas kuptimeve që jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) u ka dhënë këtyre të drejtave. Kjo sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila obligon institucionet që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore ti interpretojnë në përputhje me jurisprudencën e kësaj Gjykate.

Megjithatë, 17 vite pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, niveli i aplikimit të jurisprudencës së GjEDNJ nuk është në nivelin e dëshiruar. Monitorimi i realizuar evidentoi se jurisprudenca e GjEDNJ u aplikua në vetëm 2% të seancave gjyqësore dhe në 13% të aktgjykimeve të nxjerra. Përqindja më e lartë e aplikimit të kësaj jurisprudence evidentohet tek Gjykatat Themelore (21%) derisa përqindja më e ulët evidentohet tek Gjykata e Apelit (2%). Ndërsa, për nga natyra e rasteve, përqindja më e lartë e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNJ evidentohet tek rastet civile (18.7%). Përkundër rëndësisë, monitorimi nuk evidentoi asnjë rast kur avokatët aplikuan jurisprudencën e GjEDNJ.

Monitorimi evidentoi se jo në të gjitha rastet jurisprudenca e GjEDNJ u aplikua në mënyrë adekuate. Në 33.3% të aktgjykimeve në të cilat u evidentua aplikimi i jurisprudencës së GjEDNJ, ky aplikim është bërë vetëm në mënyrë të përgjithshme, pa specifikuar një vendim specifik. Ky fakt e ul konsiderueshëm përqindjen e zbatimit adekuat të jurisprudencës së GjEDNJ nga gjyqësori.

Njëra ndër të drejtat e garantuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Për këtë të drejtë, GjEDNJ ka etabluar standarde të qarta. Në lidhje me respektimin e kësaj të drejte, monitorimi ka gjetur se në parim, Gjykatat në Kosovë shkelin të drejtën e qytetarëve për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Monitorimi ka gjetur se mësatarka kohore e zgjidhjes së një çështjeje në shkallën e parë është 1,256 ditë. Kjo periudhë kohore, në parim, tejkalon gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kështu, aktualisht, Gjyqësori i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të garantojë gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Megjithatë, për këtë situatë, faji nuk është ekskluzivisht i gjyqësorit. Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura me të cilat ballafaqohet sistemi gjyqësor pamundëson trajtimin e lëndëve brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në këtë drejtim, përpjekjet e sistemit gjyqësor nuk krijuan rezultate. Përkundër rritjes së numrit të lëndëve të zgjidhura ndër vite, prap numri i lëndëve të pazgjidhura u ngrit. Arsye për këtë është mos përmbushja e obligimeve nga ana e institucioneve publike, të cilat detyrojnë qytetarët që të drejtat e tyre ti realizojnë përmes rrugëve gjyqësore.

Kosovës i mungon një mekanizëm për adresimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Projektligji i MD-së që tentonte ta bëjë këtë, ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe rrezikonte të cenonte seriozisht administrimin e drejtësisë në gjykata.

Në lidhje me barazinë e armëve, në kontekst të jurisprudencës së GjEDNj, monitorimi gjeti se me disa përjashtime, mënyra e administrimit të provave nga ana e gjykatave është në përputhje me standardet e jurisprudencës së GjEDNj. Tutje, në lidhje me parimin e barazisë së armëve, monitorimi gjenë se ky parim cenohet konsiderueshëm në raport me shqyrtimin e ankesave të palëve nga Gjykata e Apelit. Sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GjEDNj, gjykatat janë të obliguara të arsyetojnë pretendimet e palëve, për të dëshmuar se ato janë dëgjuar. Megjithatë, monitorimi tregon se në 48.4% të rasteve të analizuara, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë përgjigje për pretendimet e ngritura, dhe nuk ka sqaruar nëse ato ishin vendimtare.

Tutje, monitorimi ka evidentuar se në gjykatat e Kosovës përmbushen mjaftueshëm kërkesat e KEDNj-së dhe jurisprudenca e GjEDNj-së lidhur me mbrojtjen juridike profesionale. Megjithatë, në kundërshtim me këtë jurisprudencë është sistemi si funksionon Agjencia për Ndhmë Juridike Falas.

Sipas KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, publiciteti i seancave gjyqësore është i garantuar. Monitorimi tregon se të gjitha seancat ishin publike, por se mungesa e publikimit të tyre në orarin zyrtar bie ndesh me standardet e GjEDNj-së.

Sekuestrimi i pasurisë në procedurë penale, ashtu siç zbatohet aktualisht, nuk përmbush standardet e GjEDNj-së në lidhje me të drejtën në pronë. Në pesë rastet e monitoruara pasuritë mbetën të sekuestruara mesatarisht 1,263 ditë, pa u rishqyrtuar nga gjykata. Në lidhje me mbrojtjen e pronës, monitorimi ka evidentuar se proporcionaliteti cenohet edhe në rastet e masave të sigurisë ndaj aseteve të caktuara, të cilat vendosen gjatë një procedure civile.

Monitorimi ka evidentuar se gjykatat kanë respektuar në plotëni të drejtat gjuhësore të palëve në procedurë.

Monitorimi nuk evidentoi raste të cenimit të parimit të barazisë së armëve nga ana e gjykatave. Megjithatë, u evidentua cenim i këtij parimi nga akterët politik, përmes deklaratave ndërhyrëse ndaj sistemit të drejtësisë.

Ndërkaq, monitorimi evidentoi edhe se në disa raste mund të ngritën dyshime se akustika në sallën e gjykimit cenon standardet e përcaktuara nga GjEDNj.

Metodologjia

Nga data 1 qershor 2024 deri më 31 maj 2025, në kuadër të Projektit “përgatitja e institucioneve të Kosovës për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, të financuar nga Ambasada Gjermane në Kosovë, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Lëvizja Fol dhe Iniciativa për Progres (INPO) kanë realizuar monitorimin e zbatimit të jurisprudencës së GjEDNj në gjykata dhe institucione të pavarura. Monitorimi është bërë duke u bazuar në një metodologji të paracaktuar, që synon të evidentojë nivelin e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së dhe standardeve të saj nga gjykatat dhe institucionet e pavarura.

Para fillimit të procesit të monitorimit, janë hulumtuar dhe zhvilluar fushat e jurisprudencës së GjEDNj në të cilat është shtrirë monitorimi. Monitorimi mbi këto fusha ka synuar që të ofrojë një pasqyrë reale në lidhje me aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj-së, në kuptimin kuantitativ, dhe standardeve të GjEDNj-së, në kuptimin kualitativ.

Për secilën fushë të monitorimit, janë draftuar indikatorët specifik matës, përmes të cilëve është vlerësuar aplikimi i jurisprudencës dhe standardeve të GjEDNj-së. Kështu, të gjitha gjetjet e paraqitura në këtë raport janë gjeneruar përmes indikatorëve specifikë relevant.

Me qëllim të pasqyrimit të nivelit të zbatimit të jurisprudencës dhe standardeve të GjEDNj-së, është zhvilluar një metodologji mikse e monitorimit dhe hulumtimit. Kjo metodologji ka përfshirë:

- 1) Monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave gjyqësore;
- 2) Analizimin e aktgjykimeve të gjykatave;
- 3) Analizimin e shkresave nga dosjet gjyqësore;
- 4) Analizimin e ankesave të avokatëve;
- 5) Analizimin e vendimeve të institucioneve të pavarura.

Sa i përket mostrës, procesi i monitorimit ka përfshirë monitorimin e 100 seancave gjyqësore, analizimin e 200 aktgjykimeve, analizimin e 15 dosjeve gjyqësore dhe ankesave të avokatëve dhe analizimin e 60 vendimeve të institucioneve të pavarura. Monitorimi dhe analizi ka përfshirë rastet e natyrës penale, civile dhe administrative të të gjitha shkallëve e sistemit gjyqësor.

Po ashtu, monitorimi ka përfshirë edhe pesë (5) institucione të pavarura (Agjencia për Informim dhe Privatësi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbyesve Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Autoriteti i Konkurrencës).

Këtë formë të monitorimit e ka mundësuar qasja bashkëpunuese e sistemit gjyqësor. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë vendim me të cilin ka lejuar qasjen në shkresa të lëndës për qëllime të këtij monitorimi derisa gjatë zhvillimit të procesit të monitorimit, të gjitha gjykatat kanë pasur një qasje bashkëpunuese. Po ashtu, gjykatat dhe institucionet e tjera kanë treguar bashkëpunim edhe në fazën e konsolidimit të këtij raporti, përmes pjesëmarrjes së tyre në takimet e organizuara me qëllim të diskutimit të çështjeve të ndryshme të cilat ndërlidhen me këtë raport.

Të dhënat e evidentuara nga ky monitorim janë grumbulluar, përpunuar dhe analizuar. Kombinimi i formave të monitorimit dhe hulumtimit ka mundësuar gjenerimin e gjetjeve reale mbi fushat relevante.

Pas gjenerimit të gjetjeve nga procesi i monitorimit, gjetjet janë analizuar në kontekst të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së, si dhe në kontekst të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjeve në fuqi. Kjo mënyrë e analizimit dhe paraqitjes së gjetjeve ka mundësuar që ky raport të paraqesë një gjendje reale dhe specifike në lidhje me aplikimin e jurisprudencës dhe standardeve të GjEDNJ-së nga gjykatat dhe institucionet e pavarura.

Të gjitha gjetjet janë diskutuar në katër takime të ndryshme, dy diskutime virtuale dhe dy fokus grupe me të gjithë akterët relevantë, ku përfshihen: anëtarë të KGjK-së, gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë, profesor, avokatë dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Para publikimit, ky raport është ndarë si draft për komente me të gjithë akterët relevantë.

Pozita e jurisprudencës së GjEDNj-së në rendin juridik kosovar

“Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit” thuhet në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ky përkushtim i proklamuar, reflektohet edhe në pjesën materiale të Kushtetutës, në të cilën mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore zë rolin qendror. Në përkufizimin kushtetues të shtetit thuhet se “Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj”. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut përcaktohet edhe si vlerë e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës[1].

Të drejtat e njeriut janë kategorizuar në kapitullin II të Kushtetutës, derisa Kapitulli III i saj përcakton të drejta të zgjeruara për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë. Sipas Kushtetutës[2] të drejtat e njeriut nuk mund të pakësohen as përmes ndryshimit të kushtetutës.

Edhe sa i përket volumit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës më së shumti nene ka paraparë në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kapitullin II të Kushtetutës, janë përcaktuar gjithsej 36 nene që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut. Po ashtu, Kushtetuta u ka dhënë zbatueshmeri direkte edhe nëntë (9) instrumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku bën pjesë edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj[3].

Në kuadër të gjithë këtij rregullimi kushtetues të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, jurisprudenca e GjEDNj-së ka një pozitë të veçantë. Siç u tha, rendi kushtetues kosovar garanton shumë të drejta të njeriut. Por se, kuptimi i atyre të drejtave është ai kuptim që i ka dhënë kjo gjykatë. Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se “sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjykatat e Republikës së Kosovës, të gjitha pa përjashtim, e kanë për obligim që të interpretojnë “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Kjo do të thotë që, në të gjitha instancat kur GjK ose gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës i interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, duhet të zbatohen për këto të drejta dhe liri, kur kjo është e zbatueshme. Në rast konflikti midis të dyjave, standardet e vendosura nga GjEDNj në interpretimin e KEDNJ-së do të mbizotërojnë”[4].

Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar jurisprudencën e GjEDNj si pikë reference në interpretimin e të drejtave të njeriut. Kështu, Kushtetuta përcakton se të drejtat e njeriut mbrohen sipas kuptimit që GjEDNj u ka dhënë këtyre të drejtave.

[1] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 1.2 dhe neni 7.

[2] Po aty, neni 144.3.

[3] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

[4] “AKTGJYKIM në rastin nr. KI207/19”. Gjykata Kushtetuese. Paragrafi 109. Prishtinë, 5 janar 2021. (Shih linkun: https://gjkapi.pbc.group/Custom/ki_207_19_agj_shq.pdf).

Rëndësia e zbatimit të jurisprudencës së GjEDNj-së

Për shkak se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të interpretohen në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së, aplikimi i kësaj jurisprudence është parakusht për mbrojtje të të drejtave të njeriut, sipas mënyrës se si Kushtetuta e ka përcaktuar se bëhet kjo mbrojtje. Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nga institucionet është i një rëndësie kruciale për disa arsye.

Fillimisht, aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së është obligativ sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kështu, aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së paraqet thjesht zbatim të Kushtetutës.

Tutje, përmes aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së, rendi juridik kosovar, në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, harmonizohet me praktikën e GjEDNj-së. Një harmonizim i tillë është domosdoshmëri në rast të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, të cilin anëtarësim Kosova e cilëson si synim shtetëror.

Është me rëndësi të theksohet se në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore shpeshherë mund të lindin dilema të ndryshme, varësisht nga rrethanat e secilit rast. Jurisprudenca e GjEDNj-së, e zhvilluar ndër vite përmes një numri të konsiderueshëm vendimesh, ka qartësuar një numër të madh të standardeve në këtë fushë. Kësisoj, kjo jurisprudence, përpos obligim kushtetues, mundëson zgjidhjen e dilemave të cilat mund të shfaqen në praktikë.

Kështu, aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në rendin juridik kosovar, përtej një obligimi kushtetues, paraqet rëndësi shumë dimensionale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Njëra prej përfundimeve të dala nga fokus grupi i organizuar për qëllime të draftimit të këtij raporti ishte se aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj, ndër të tjera, rrit besueshmërinë tek publiku dhe palët ndërgjyqëse.

Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nga gjykatat

Përkundër faktit se zbatimi i jurisprudencës së GjEDNj është obligim për të gjitha institucionet, rëndësia primare për zbatimin e saj shfaqet tek gjykatat. Megjithatë, nga monitorimi i drejtpërdrejt i 100 seancave gjyqësore, jurisprudenca e GjEDNj-së është përmendur në vetëm dy raste, njëri penal dhe tjetri civil. Kështu, shprehur në përqindje i bie se jurisprudenca e GjEDNj-së, në kuptim të aplikimit të saj gjatë seancave gjyqësore, është aplikuar në vetëm 2% të rasteve të monitoruara.

Në sa seanca gjyqësore u përmend jurisprudenca e GjEDNj-së?



Grafiku 1: Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së gjatë seancave gjyqësore

Në të dy rastet, jurisprudenca e GjEDNj-së është përmendur nga gjyqtarët. Kështu, gjatë monitorimit, nuk janë evidentuar raste kur jurisprudenca e GjEDNj-së është përmendur nga palët e tjera ndërgjyqëse. Kjo situatë flet për mungesë të njohurive të palëve lidhur me jurisprudencën e GjEDNj-së, përmes të cilës do të mund të tentonin të mbronin pretendimet e tyre para gjykatave.


Një përqindje më e lartë e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së evidentohet në aktgjykimet e nxjerra nga gjykatat. Në këtë drejtim, nga 200 aktgjykime të analizuara, monitorimi gjen se gjykatat në 26 prej tyre, e kanë aplikuar jurisprudencën e GjEDNj-së, derisa nuk e kanë bërë këtë në 174 aktgjykime të tjera.

Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në vendimet e gjykatave




Grafiku 2: Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në vendimet e gjykatave

IPër nga natyra e rasteve, përqindja më e madhe e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së rezulton të jetë në fushën civile. Kështu, sipas aktgjykimeve të analizuara, në aktgjykimet e natyrës civile, jurisprudenca e GjEDNj-së është aplikuar në 18.7% të rasteve të monitoruara, pasuar nga rastet e natyrës administrative (10%). Përderisa, sa i përket rasteve të natyrës penale, jurisprudenca e GjEDNj-së është aplikuar në 8.7% të rasteve.



Grafiku 3: Përqindja e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së sipas natyrës së rasteve

Monitorimi ka përfshirë edhe aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj-së sipas niveleve të gjykatave. Bazuar në monitorimin e realizuar, rezulton se përqindja më e lartë e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së është në aktgjykimet e gjykatave themelore, me 21% e aktgjykimeve të analizuara. Përderisa, kjo përqindje e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në aktgjykimet e Gjykatës Supreme (8%) dhe Gjykatës së Apelit (2%) rezulton të jetë shumë më e ulët.



Grafiku 4: Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së sipas niveleve të gjykatave

Në këtë drejtim, duhet theksuar se përkundër faktit se të drejtat e njeriut janë vazhdimisht çështje relevante në aktgjykimet e gjykatave, mund të evidentohen raste kur specifikat e rastit konkret nuk paraqesin nevojën e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së. Megjithatë, kjo do të mund të ishte arsyetim nëse gjykatat në pjesën më të madhe të aktgjykimeve të nxjerra aplikojnë jurisprudencën e GjEDNj-së, dhe jo në situatën kur rezulton se GjEDNj gjen aplikim në vetëm rreth një në shtatë vendime, përkatësisht 13%. Për këtë arsye, monitorimi gjen se në parim, gjykatat nuk aplikojnë në masë adekuate jurisprudencën e GjEDNj-së në aktgjykimet e tyre.

Lidhur me aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj nga ana e gjyqtarëve, në fokus grup u përmendën disa shkaqe që e pengojnë aplikimin e kësaj jurisprudence . Një prej këtyre shkaqeve u tha se është edhe koha që nevojitet gjyqtarëve për të hulumtuar jurisprudencën e GjEDNj. Si pengesë për ta bërë këtë u përmend ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë dhe mungesa e resurveve. Gjatë fokus grupeve u tha se një mënyrë adekuate për të ngritur aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj është hulumtimi i kësaj jurisprudence për grupe të ndryshme të çështjeve që trajtohen nga gjyqësori, i cili hulumtim do të shërbente në shumë aktgjykime të llojit të njëjtë.

Për këtë të fundit, u tha se është një element tejet i rëndësishëm i sigurisë juridike, pra konsistenca e vendimeve dhe jo kontradiktat mes tyre

Cilësia e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së


Duke interpretuar KEDNj-në, GjEDNj ka përcaktuar standarde të rëndësishme dhe shumë specifike për shumë fusha konkrete. Në kontekst të aplikimit të kësaj jurisprudence, duke i kontekstualizuar rastet konkrete, mbrojtja e pretendimeve para gjykatave mund të jetë më efektive derisa cilësia e drejtësisë së dhënë nga gjykatat më cilësore. Kështu, përderisa interpretimi i të drejtave të njeriut duhet të bëhet në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së, nuk mjafton referimi abstrakt në këtë jurisprudence, por se aplikimi i kësaj jurisprudence nënkupton aplikimin e rasteve specifike të saj, duke i kontekstualizuar në rrethanat e rastit konkret.

Në dy (2) seancat e vetme gjyqësore në të cilat u përmend jurisprudence e GjEDNj-së, nuk u përmend asnjë rast specifik apo ndonjë standard specifik i vendosur nga kjo jurisprudence. Në këto dy (2) raste, gjyqtarët përmendën vetëm në përgjithësi jurisprudencën e GjEDNj-së, pa e specifikuar ndonjë vendim të caktuar të kësaj jurisprudence.


Ndërsa, sa i përket 26 aktgjykimeve në të cilat u përmend jurisprudence e GjEDNj-së, në 17 prej tyre janë përmendur vendime specifike nga jurisprudence e GjEDNj-së. Përderisa, në të gjitha këto raste është gjetur se citimi i aktgjykimit të GjEDNj-së ka qenë i saktë. Ndërsa, në nëntë (9) raste të tjera, jurisprudence e GjEDNj-së është përmendur vetëm në përgjithësi.

Përqindja më e lartë e referimit specifik në jurisprudencën e GjEDNj-së rezulton të jetë në aktgjykimet e natyrës civile. Nga aktgjykimet e kësaj natyre, rezulton se jurisprudence e GjEDNj-së është përdorur në mënyrë specifike në 15% të rasteve, ndërsa është përdorur në mënyrë të përgjithësuar në 2.5% të rasteve. Në rastet administrative, monitorimi gjen se jurisprudence e GjEDNj-së është aplikuar në mënyrë specifike në 7.5% të rasteve, ndërsa është aplikuar në mënyrë të përgjithësuar në 2.5% të rasteve. Ndërkaq, situatë krejt e kundërt rezulton në rastet e natyrës penale, ku vendime specifike janë aplikuar në vetëm 2.5% të rasteve, përderisa në 6.2% të rasteve GjEDNj është aplikuar vetëm në përgjithësi.


Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj në çështje civile



Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj në çështje penale




Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj në çështje administrative




Grafiku 5: Aplikimi i vendimeve specifike të GjEDNj-së sipas natyrës së rasteve

Sa i përket instancës gjyqësore, përqindja më e lartë e referimit specifik në aktgjykimet e GjEDNj-së evidentohet në aktgjykimet e gjykatave themelore. Përqindja e aplikimit të vendimeve specifike të GjEDNj-së në vendimet e këtyre gjykatave rezulton të jetë 14%, derisa në 7% të rasteve aplikimi ka qenë vetëm i përgjithshëm.


Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në Gjykatat Themelore



Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në Gjykatën e Apelit



Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në Gjykatën Supreme



Grafiku 6: Aplikimi i vendimeve specifike të GjEDNj-së sipas instancave gjyqësore

Në këtë drejtim, duhet theksuar faktin se aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nuk është një aspekt formal dhe nuk mjafton përmendja e saj abstrakte. Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka një qëllim real, e që është mbrojtja e të drejtave të njeriut sipas standardeve specifike që ka vendosur jurisprudenca e GjEDNj-së. Kështu, detyrimi kushtetues për aplikim të jurisprudencës së GjEDNj-së nuk përmbushet thjesht përmes përmendjes abstrakte të kësaj jurisprudence, por se nevojitet referimi në raste specifike të GjEDNj-së dhe aplikimi i standardeve të vendosura nga kjo gjykatë në kontekst të rrethanave të rasteve specifike.

Sa i përket cilësisë së aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj, u diskutua edhe në fokus grup. Mes tjerash, u tha se referenca duhet të jetë adekuate. Pra, u tha se është e rëndësishme që jo vetëm të përmendet një vendim specifik, por edhe se vendimi i përmendur ti përshtatet specifikave të rastit përkatës. Përderisa, u theksua se në aspektin e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj duhet të ndihmoj edhe Akademia e Drejtësisë, përmes trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe duke u shfrytëzuar memorandumet me OJQ-të por edhe me profesionistë tjerë të fushës

Departamenti Special	
Viti	Numri i rasteve
2013	1
2022	1
2024	1

Departamenti për Krime të Rënda	
Viti	Numri i rasteve
2009	1
2012	1
2016	1
2017	1
2018	1
2019	1
2020	4
2021	1
2022	2
2023	2
2024	3
2025	1

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal	
Viti	Numri i rasteve
2006	1
2016	1
2017	1
2019	1
2020	1
2022	1
2023	2
2024	7
2025	3

Departamenti për Çështje Administrative	
Viti	Numri i rasteve
2015	1
2017	1
2019	2
2022	6
2023	7
2024	1
\\	2

Departamenti i Përgjithshëm - Diviioni Civil	
Viti	Numri i rasteve
2006	1
2011	1
2015	3
2016	3
2018	1
2019	1
2020	7
2021	3
2022	3
2023	5
2024	5
2025	1
\\	6

Tabela 1: Numri i rasteve sipas vitit të inicimit

Duhet pasur parasysh se llogaritja e mësipërme është bërë nga momenti i inicimit të rastit e deri në aktgjykimin e shkallës së parë, derisa sipas GjEDNj-së, kohëzgjatja e shqyrtimit të një rasti llogaritet nga momenti i inicimit të rastit e deri në plotfuqishmërinë e tij[8]. Kështu, në kuptim të standardeve të GjEDNj-së, kjo kohëzgjatje është ende më e lartë.


Gjetjet e monitorimit tregojnë për një shkelje në masë të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Mesatarja e përgjithshme prej 1,256 ditëve e trajtimit të rasteve flet për pamundësi të sistemit gjyqësor që të ofroj drejtësi brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç garantohet me nenin 6 të KEDNj-së.

Në këtë situatë, është e domosdoshme që të zhvillohen reforma dhe ndryshim të sjelljes institucionale, në mënyrë që gjyqësori të jetë i aftë për të garantuar shqyrtim të rasteve brenda një afati të arsyeshëm kohor. GjEDNj në jurisprudencën e saj theksoi se mjetet që duhet zgjedhur për të adresuar shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor duhet t'i përshtaten kontekstit specifik të situatës së gjyqësorit në një shtet të caktuar[8]. Kështu, me qëllim të njohjes mbi mjetet që duhet aplikuar, me qëllim të shmangies së shkeljes së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, është e rëndësishme që të sqarohen shkaqet se pse krijohen vonesat në shqyrtimin e rasteve gjyqësore.

Njëra ndër arsyet kryesore që shkakton vonesa në trajtimin e rasteve gjyqësore është ngarkesa e madhe e gjykatave me lëndë. Kjo është jashtëzakonisht shumë e shprehur në fushën civile. Por, fatkeqësisht, kjo situatë ndër vite ka ardhur vetëm duke u përkeqësuar. Përderisa në fund të vitit 2018 numri i lëndëve të pazgjidhura ishte 44,213, në fund të vitit 2024, ky numër është ngritur në 121,324 lëndë.

Viti | Numri i rasteve të pazgjidhura

2018	44,213
2019	47,926
2020	64,414
2021	85,087
2022	99,407
2023	112,623
2024	121,324



Grafiku 7: Numri i rasteve të pazgjidhura 2018 - 2024


[8] "CASE OF NEUMEISTER v. AUSTRIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 27 qershor 1968. Paragrafi 18. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57544%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57544%22]})); "CASE OF KÖNIG v. GERMANY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 28 qershor 1978. Paragrafi 98. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57512%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57512%22]})); "CASE OF POISS v. AUSTRIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 23 prill 1987. Paragrafi 50. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57560%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57560%22]})).

[9] "CASE OF SCORDINO v. ITALY (No. 1)". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 183. Strasburg, 29 mars 2006. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-72925%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-72925%22]})), (Qasur për herë të fundit 29 qershor 2024); "CASE OF TOMAŽIČ v. SLOVENIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 37. Strasburg, 13 Dhjetor 2007. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22fulltext%22:\[%22Case%20of%20Tomazic%20v.%20Slovenia%22\],%22itemid%22:\[%22001-83973%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22fulltext%22:[%22Case%20of%20Tomazic%20v.%20Slovenia%22],%22itemid%22:[%22001-83973%22]})).

Ngjitja e numrit të gjyqtarëve dhe ngjitja e efikasitetit në punën e gjyqtarëve ka rezultuar me rritjen afër pesë (5) fish të numrit të lëndëve të zgjidhura përgjatë viteve 2018-2024. Përderisa gjatë vitit 2018 gjyqtarët kishin zgjidhur 16,768 lëndë, numri i rasteve të zgjidhura në vitin 2024 ishte 80,448.

Viti / Numri i rasteve të zgjidhura

2018	/ 16,768
2019	/ 20,335
2020	/ 20,329
2021	/ 23,077
2022	/ 25,632
2023	/ 38,554
2024	/ 80,448




Grafiku 8: Numri i rasteve të zgjidhura 2018 - 2024

Kështu, rritja afër pesë (5) fish e numrit të lëndëve të zgjidhura për vit nga gjyqësori nuk ka ndikuar në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura, të cilat pothuajse janë trefishuar. Kjo pasi rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura është shoqëruar me një rritje jo natyrale të numrit të lëndëve të pranura si rezultat i mos përmbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve publike, të cilët kanë detyruar qytetarët që të drejtat e tyre t'i realizojnë nëpërmjet rrugëve gjyqësore.

Viti / Numri i rasteve të pranura

2018	/ 19,609
2019	/ 24,048
2020	/ 29,319
2021	/ 43,536
2022	/ 40,826
2023	/ 53,767
2024	/ 89,926



Grafiku 9: Numri i rasteve të pranura 2018 - 2024

Një pjesë e madhe e këtyre rasteve derivojnë nga obligimet sipas kontratave kolektive, të cilat obligime nuk u përmbushën nga institucionet publike, ashtu që qytetarët u obliguan që të ndjekin rrugën gjyqësore[9]. Në këtë mënyrë, Qeveria ka vepruar edhe në raport me pensionet e dyfishta, ku përkundër faktit se kategorive të caktuara u është njohur e drejta për pension të dyfishtë, Qeveria nuk ua ka njohur këtë të drejtë, duke i obliguar të njëjtit që të drejtat e tyre t'i kërkojnë përmes rrugëve gjyqësore[11].

Përtej kësaj, tanimë është krijuar edhe një burim tjetër i rasteve gjyqësore, që rrezikon vërshimin e lëndëve në gjyqësor. Mos përmbushja e obligimeve kushtetuese nga ana e Kuvendit në lidhje me Ligjin NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik rrezikon ta ngarkojë gjyqësorin me dhjetëra mijëra lëndë[12].

[10] "Kostoja e pagave jubilarë të papaguara". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, shtator 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/09/IKD-Kosto-e-pagave-jubilar-te-papaguara-2.pdf>).

[11] "Qeveria e Kosovës është duke shkelur të drejtat e pensionistëve për pension të dyfishtë". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, 14 qershor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/qeveria-e-kosoves-eshte-duke-shkelur-te-drejtat-e-pensionisteve-per-pension-te-dyfishte/>).

[12] Shala, G. dhe Jakaj, N. "MOSVEPRIMI I KUVENDIT SHKEL TË DREJTAT E 90,696 ZYRTARËVE PUBLIK DHE RREZIKON BUXHETIN SHTETËROR". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, mars 2025. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2025/03/Mosveprimi-i-kuvendit-shkel-te-drejtat-e-90696-zyrtareve-publik-dhe-rrezikon-buxhetin-shteteror.pdf>); "Tempus 156: Ri-vërshimi i gjyqësorit me lëndë". Betimi për Drejtësi. 5 maj 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/tempus-156-ri-vershimi-i-gjyqesorit-me-lende/>).

Në këtë situatë, gjyqësori normalisht se do ta ketë të pamundur të ofrojë drejtësi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, përgjegjës për të garantuar gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor nuk është vetëm gjyqësori, por edhe institucionet e tjera[13].

Në këtë situatë, në mënyrë që gjyqësori të jetë në gjendje të garantoj gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, institucionet publike duhet të rregullojnë vendimmarrjen e tyre, në atë mënyrë që të përmbushin detyrimet që kanë, duke mos detyruar qytetarët që të drejtat e tyre t'i kërkojnë nëpërmjet gjyqësorit. Vetëm kjo qasje do të mund të lehtësonte ngarkesën e gjyqësorit me lëndë, në mënyrë që gjyqësori të jetë në gjendje të garanton gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Me qëllim të adresimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, Ministria e Drejtësisë ka publikuar për konsultime publike Projektligjin për Realizimin e të Drejtës për Gjykim brenda një Afati të Arsyeshëm Kohor. Përkundër qëllimit legjitim, përmbajtja e draftit të publikuar për konsultime publike nuk e adreson qëllimin e synuar.

Projektligji ka përcaktuar afatet kohore të gjykimit, të cilat konsiderohen si afate të arsyeshme: tri (3) vite në shkallë të parë dhe dy (2) vite në shkallë të dytë. Përcaktimi i këtyre afateve si kritere për përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm kohor është në kundërshtim të hapur me standardet e vendosura nga GjEDNj në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor. GjEDNj ka përcaktuar decidivisht se nuk mund të ketë një kriter uniform lidhur me vlerësimin e arsyeshmërisë së afatit kohor, por kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, sipas kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj[14]. Pas përcaktimit të afateve kohore, Projektligji i liston kriteret e GjEDNj-së si kritere përjashtimore, por jo si kritere bazike për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së gjykimit[15].

Kështu, nisur nga fakti se çështja e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës duhet të interpretohet në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së, rezulton se përmbajtja e Projektligjit në fjalë është kundërkushtetuese. Përkitazi me këtë Projektligj, pas publikimit në platformën e konsultimeve publike, përtej një takimi të mbajtur, Ministria e Drejtësisë nuk ka njoftuar se si ka proceduar tutje.

Si përfundim, gjetjet e monitorimit dhe analiza e realizuar tregojnë për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së hapave me qëllim të jetësimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, shkelja e së cilës të drejtë është parim në sistemin gjyqësor. Zgjidhja e kësaj situatë kërkon angazhim të gjerë ndërinstitucional që tejkalon edhe gjyqësorin. Reformat e marra në këtë fushë duhet të jenë në linjë me jurisprudencën e GjEDNj-së dhe, siç vet kjo jurisprudencë kërkon[16], në përputhje me rrethanat specifike.

[13] "CASE OF MARTINS MOREIRA v. PORTUGAL". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 60. Strasburg, 26 tetor 1988. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-57535%22%7D>).

[14] "CASE OF COMINGERSOLL S.A. v. PORTUGAL". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 19. Strasburg, 6 prill 2000. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22%3A%22Case%20of%20Comingersoll%20S.A.%20v.%20Portugal%22%22%22itemid%22%3A%22001-58562%22%7D>)). (Qasur për herë të fundit më 8 maj 2025).

[15] Shala, G. "GYKIMI BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 9. Prishtinë, korrik 2024. (Shih linkun: <https://kji-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Gjykimi-brenda-afatit-te-arsyeshem-1.pdf>).

[16] "CASE OF SCORDINO v. ITALY (No. 1)". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 185. Strasburg, 29 mars 2006. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-72925%22%7D>); "CASE OF TOMAŽIČ v. SLOVENIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 37. Strasburg, 13 Dhjetor 2007. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22fulltext%22%3A%22Case%20of%20Tomazic%20v.%20Slovenia%22%22%22itemid%22%3A%22001-83973%22%7D>); "CASE OF FINGER v. BULGARIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 127. Strasburg, 10 maj 2011; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-104698%22%7D>); "CASE OF ROBERT LESJAK v. SLOVENIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 36. Strasburg, 21 korrik 2009; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-93660%22%7D>)). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

- 2.1. marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme;
- 2.2. fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar;
- 2.3. prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme; ose
- 2.4. kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën[19].

Sa i përket procedurave civile, Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore ka përcaktuar se “[p]alët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla” dhe se “[g]ykata është e autorizuar t’i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t’i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”. Sipas këtij Ligji, “[g]ykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”[21].

Në anën tjetër, në kontekst të standardeve të vendosura nga GjEDNj, duhet theksuar se përkundër faktit se çështja e provave është çështje që rregullohet nga legjislationet e brendshme, nuk mund të thuhet se çështja e provave nuk është subjekt i trajtimit nga jurisprudenca e kësaj gjykate. Kjo duke pasur parasysh faktin se në raste specifike, mënyra e administrimit të provave mund të jetë një faktor determinues në lidhje me vlerësimin përfundimtar të respektimit të barazisë së armëve.

24

Sipas Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale dhe Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë të parashtojë propozime për dëgjimin e dëshmitarëve apo nxjerrjen e provave të reja. Përkundër se neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] nuk përfshinë dispozita specifike në lidhje me marrjen e provave, jurisprudenca e GjEDNJ-së theksoi se sipas këtij neni, procedura në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, duhet të jenë “të drejta”[24].

1. Gjykatat duhet t'i përgjigjen një kërkesë për dëgjimin e një dëshmitari, nëse kërkesa është parashtruar në mënyrë të përshtatshme[25];
2. Në rastin kur refuzohet një kërkesë për dëgjimin e një dëshmitari, Gjykatat duhet të arsyetojnë këto vendime, ashtu që refuzimi mos të jetë një veprim arbitrar dhe që cenon mendësitë e palëve ndërgjyqëse për të paraqitur argumente në favor të tyre[26];

Në këtë mënyrë, përgjithësisht, shihet se jurisprudenca e GjEDNj-së përkundër se sjellë në vëmendje faktin se dispozitat në lidhje me administrimin e provave nuk gjenden në nenin 6 të KEDNj-së, çështjet në lidhje me administrimin e provave bien brenda rregullimit të KEDNj-së dhe rrjedhimisht, shqyrtimit nga GjEDNj. Duke ruajtur margjinën e vlerësimit të lirë të gjykatave, GjEDNj theksoi se, në raport me çështjet e administrimit të provave, do të ketë shkelje të nenit 6 atëherë kur vlerësohet se mënyra e administrimit të provave ka cenuar drejtshmërinë e një procesi gjyqësor.

Kështu, me një përjashtim, gjetjet nga monitorimi i realizuar dëshmojnë se, në raport me mënyrën e administrimit të propozimeve për nxjerrjen e provave të reja, gjykatat nuk e kanë cenuar drejtshmërinë e proceseve gjyqësore.

[25] "CASE OF CARMEL SALIBA v. MALTA", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paragrafi 77, Strasburg, 29 nëntor 2016. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng/%7B%22itemid%22%3A%22001-169057%22%7D>).

[26] "CASE OF WIERZBICKI v. POLAND". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 45. Strasburg, 18 qershor 2002. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng/#f%7B%22itemid%22:%5B%222001-60507%22%5D%7D>)).

[27] "CASE OF LETINČIĆ v. CROATIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 50. Strasburg, 3 maj 2016. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng/#f%2Ditemid%2D%2D22001-162422%2D22>)).

[28] "CASE OF ELSHOLZ v. GERMANY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 66. Strasburg, 13 korrik 2000. [Shih linkun:<https://hudoc.echr.coe.int/eng/#%7B%22itemid%22:%5B%22001-58763%22%5D%7D>).

b. Shqyrtimi i pretendimeve

Garancitë e ofruara sipas nenit 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet e marra. Jurisprudenca e GjEDNj-së ka theksuar se KEDNj synon të garantojë jo të drejta që janë vetëm teorike, por të drejta që janë praktike dhe efektive. E drejta për një gjykim të drejtë nuk mund të konsiderohet efektive nëse pretendimet e palëve nuk “dëgjohen” vërtet, pra nuk shqyrtohen në mënyrë të duhur nga trupi gjykues.

GjEDNj në jurisprudencën e saj ka theksuar se vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë në mënyrë të përshtatshme arsyet mbi të cilat ato bazohen[29]. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, vendimet e gjykatave duhet të shprehin në mënyrë të përshtatshme arsyet mbi të cilat janë mbështetur. Pa kërkuar përgjigje të detajuar për çdo pretendim apo argument të ngritur, detyrimi për të dhënë arsyetim nënkupton se palët në procedurë gjyqësore kanë të drejtë të presin një përgjigje specifike dhe të qartë për argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës gjyqësore. Sipas jurisprudencës së kësaj gjykate, shtrirja e këtij detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të çështjes[30].

Vendimet e arsyetuara kanë për qëllim t’u tregojnë palëve se janë dëgjuar, duke kontribuar kështu në një pranim më të vullnetshëm të vendimit nga ana e tyre. Mungesa e arsyetimit të vendimeve mund të krijoj perceptimin e ekzistimit të ndonjë doze të arbitraritetit në vendimet gjyqësore. Nëse pretendimet e palëve ndërgjyqëse nuk marrin përgjigje në vendimet gjyqësore, palët ndërgjyqëse mund të pretendojnë se nuk janë “dëgjuar” nga gjykata. Arsyetimi i pretendimeve të palëve ndërgjyqëse forcon pozitën e palëve në procedurë.

Në anën tjetër, duhet theksuar se arsyetimi i vendimeve gjyqësore i bënë aktgjykimet më të pranueshme për palët ndërgjyqëse. Për më tepër, arsyetimi i vendimeve ngrit edhe transparencën e vendimmarrjes, ashtu që gjykatat nuk tregojnë qartësisht vetëm vendimet e marra por edhe arsyet pse kanë ndërmarrë ato vendime, duke kontribuar kështu në ngritjen e besimit të publikut në vendimmarrjen gjyqësore.

Gjykatat duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e mbështesin vendimin e tyre. Vendimi i arsyetuar është i rëndësishëm për t’i mundësuar palës ankuese që të ushtrojë në mënyrë efektive çdo të drejtë të mundshme ankimi[31].

Sipas legjislacionit kosovar, vendimet e gjykatave themelore janë subjekt i ankimimit në Gjykatën e Apelit, e cila vepron si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës[32]. Sa i përket rasteve civile, Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore ka përcaktuar se “në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, Gjykata e shkallës së dytë duhet t’i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj”[33]. Ndërsa, sa i përket rasteve penale, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale ka përcaktuar se “në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare”[34].

[29] “CASE OF HIRVISAARI V. FINLAND”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 30. Strasburg, 27 shtator 2001. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-59682"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[30] “CASE OF MAZAHIR JAFAROV V. AZERBAIJAN”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 33-36. Strasburg, 2 prill 2020. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-202116"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)); “CASE OF MAZAHIR JAFAROV V. AZERBAIJAN”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 34-36. Strasburg, 2 prill 2020. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-202116"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[31] “CASE OF HADJIANASTASSIOU V. GREECE”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 33. Strasburg, 16 dhjetor 1992. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57779"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[32] Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykatat, neni 21.1.

[33] Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 204. .

[34] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 404.1.

Kështu, sipas KEDNj-së, jurisprudencës së GjEDNj-së dhe legjislacionit pozitiv, gjykatat janë të obliguara që të japin arsyetim në lidhje me pretendimet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Përkritazi me këtë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka nxjerrë disa vendime kur ka konstatuar se mos arsyetimi i vendimeve gjyqësore paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe KEDNj-së. Në njërin prej vendimeve të saj, Gjykata Kushtetuese theksoi se “sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, neni 6 i KEDNj-së detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtresave, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj”[35]. Në një rast tjetër, duke aplikuar standardet e vendosura nga GjEDNj, Gjykata Kushtetuese theksoi se “[g]arancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNj-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre” dhe se “[v]endimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë”. Gjykata Kushtetuese theksoi po ashtu se “[p]ërkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmerinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saja”[36].

Në këtë mënyrë, standardet në lidhje me obligimin e Gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, tanimë janë mbrojtur në disa raste edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Monitorimi i realizuar ka përfshirë edhe nivelin e arsyetimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit në raport me ankesat e parashtuara. Në këtë drejtim, duke krahasuar ankesat e parashtuara dhe vendimet e Gjykatës së Apelit, monitorimi analizoi nëse vendimet e Gjykatës së Apelit u dhanë përgjigje pretendimeve specifike të ngritura nga palët ndërgjyqëse përmes ankesave të parashtuara.

Bazuar në tetë rastet e monitoruara, rezulton se ankesat e parashtuara përshinin gjithsej 33 pretendime. Por se, krahasuar me vendimet e Gjykatës së Apelit, rezulton se vetëm 17 prej këtyre pretendimeve morën përgjigje në vendimet e Gjykatës së Apelit, derisa të paarsyetuara mbetën gjithsej 16 pretendime. Shprehur në përqindje rezulton se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë përgjigje në gjithsej 48.4% të pretendimeve të ngritura. Madje, në vendimet e saja, përkritazi me pretendimet për të cilat nuk është dhënë arsye, Gjykata e Apelit nuk ka treguar nëse këto pretendime ishin apo jo vendimtare.

Kështu, monitorimi gjënë se në këto raste, Gjykata e Apelit pothuajse në raport me gjysmën e pretendimeve të ngritura nga palët ndërgjyqëse nuk ka dhënë arsyetim. Kjo mënyrë e veprimit, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, paraqet shkelje të së drejtës për një proces të rregullt sipas nenit 6 të KEDNj-së. Në kuptim të standardeve të përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së, standarde këto të mbrojtura nga GjK në disa raste, Gjykata e Apelit është e detyruar që të jap përgjigje në pretendimet e palëve. Në raport me pretendimet jo vendimtare, nga Gjykata e Apelit kërkohet një arsyetim se cilat prej pretendimeve ankimore i ka konsideruar si jo vendimtare dhe si rrjedhojë nuk iu është përgjigjur.

[35] "AKTGJYKIM në rastin nr. KI193/19". Gjykata Kushtetuese. Paragrafi 42. Prishtinë, 31 dhjetor 2020. (Shih linkun: https://gjkapi.pbc.group/Custom/ki_193_19_agj_shq.pdf).

[36] "AKTGJYKIM në rastin nr. KI43/23". Gjykata Kushtetuese. Paragrafët 62-63. Prishtinë, 6 mars 2024. (Shih linkun: https://gjkapi.pbc.group/Custom/ki_43_23_agj_shq.pdf).

Çështja e shqyrtimit të pretendimeve u diskutua edhe në fokus grupe, ku gjithashtu u theksua se është e rëndësishme është që të citohet çdo pretendim i palës ankuese. Po ashtu, u përmend se ka raste kur ankesa përmban edhe pretendime që nuk kanë kurrfarë relevance me çështjen që është duke u gjykuar. Mirëpo, u përmend nevoja që aktgjykimet e Gjykatave të përfshijnë edhe sqarimin se cilat pretendime ishin jo relevante për vendimmarrjen, për të cilën arsye nuk u vlerësua e nevojshme të jepet arsytim

c. Ndhimja juridike falas

Ndhimja juridike falas përbën një mjet thelbësor për të garantuar drejtësi, barazi dhe funksionim të shtetit të së drejtës. Ajo siguron që çdo individ, pavarësisht nga gjendja e tij financiare, të ketë mundësi reale për të pasur qasje në përfaqësim dhe këshillim ligjor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara. Si një e drejtë e qasshme për të gjithë, dhe jo privilegj për pakicën, ndhimja juridike falas u jep qytetarëve mjete të duhura për të mbrojtur dhe ushtruar të drejtat e tyre.

Barazia e armëve nuk mund të jetësohet nëse një palë nuk ka përfaqësim profesional në procedurat gjyqësore. Për shkak të mungesës së njohurive ligjore, palët mund të humbin mundësitë e tyre ligjore. Mungesa e një përfaqësimi të tillë rrezikon që barazia e armëve të mbetet një koncept teorik.

Në raport me procedurat penale, KEDNJ e ka përcaktuar të drejtën e mbrojtjes profesionale falas si të drejtë specifike. Sipas KEDNJ-së, çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë[37]. Sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së e drejta e çdo personi të akuzuar për një vepër penale që të mbrohet në mënyrë efektive nga një avokat është një nga elementët themelorë të një gjykimi të drejtë[38].

Sa i përket legjislacionit, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale ka përcaktuar dy forma të ofrimit të mbrojtjes ligjore falas: 1) Rastet kur mbrojtja është e detyruar dhe 2) Caktimin e mbrojtësit me shpenzimet publike në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar[39].

Në raport me procedurat civile, KEDNJ e garanton mbrojtjen ligjore si një të drejtë specifike. Megjithatë, jurisprudenca e GjEDNJ-së ka theksuar se KEDNJ synon të mbrojë të drejta që janë praktike dhe efektive, në veçanti të drejtën për qasje në gjykatë. Si rrjedhojë, GjEDNJ theksoi se neni 6.1. i KEDNJ-së mund ta detyroj shtetit për të siguruar ndihmë juridike nga një avokat, kur një ndihmë e tillë rezulton e domosdoshme për të garantuar një qasje efektive në gjykatë[40]. Sipas kësaj Gjykate, çështja nëse neni 6 i KEDNJ-së kërkon ose jo sigurimin e përfaqësimit ligjor për një palë të veçantë do të varet nga rrethanat konkrete të çështjes, që duhet vlerësuar nëse, në dritën e të gjitha rrethanave, mungesa e ndihmës juridike do ta privonte palën nga një gjykim i drejtë.[41]

[37] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6.3.c.

[38] "CASE OF SALDUZ v. TURKEY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 51. Strasburg, 27 nëntor 2008. (Shih linkun:

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-89893"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)); "CASE OF IBRAHIM AND OTHERS v. THE UNITED KINGDOM". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 255. Strasburg, 13 shtator 2016. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-166680"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)); "CASE OF SIMEONOV v. BULGARIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 112. Strasburg, 12 maj 2017. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-172963"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)); "CASE OF BEUZE v. BELGIUM". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 123. Strasburg, 9 nëntor 2018. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-187802"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{))).

[39] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 56 dhe 57

[40] "CASE OF AIREY v. IRELAND". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 26. Strasburg, 9 tetor 1979. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57420"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{))).

[41] "CASE OF McVICAR v. THE UNITED KINGDOM". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 48 dhe 51. Strasburg, 7 maj 2002. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-60450"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{))).

Ligji bazik që rregullon mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike falas në Kosovë është Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-035 dhe Ligjin Nr. 08/L-063. Ndihma juridike falas u ofrohet të gjitha subjekteve që plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Në përputhje me këtë ligj, ndihma juridike përfshin, ndër të tjera, përfaqësimin në procedura civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse. Institucioni përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e kësaj ndihme është Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF).

Në rrafshin praktik, monitorimi i realizuar ka gjetur se në shumicën dërrmuese të rasteve, palët ndërgjyqëse kanë qenë të përfaqësuar nga një avokat. Sipas monitorimit rezulton se në të gjitha rastet penale, të pandehurit kanë qenë të përfaqësuar nga avokatët. Sa i përket rasteve civile, në vetëm 1 rast palët ndërgjyqëse nuk ishin të përfaqësuar nga avokatët. Ndërsa, në rastet administrative, u evidentuan 5 raste kur palët nuk ishin të përfaqësuara nga avokatët.

Nga totali i rasteve të monitoruara, rezulton se në 89 raste, avokatët ishin të caktuar sipas autorizimit ndërsa 5 raste të tjera përfshinin avokatë të caktuar sipas detyrës zyrtare.

Kështu, në praktikë rezulton se palët ndërgjyqëse pothuajse në të gjitha rastet, kanë pasur përfaqësim profesional nga një avokat. Kështu, në raport me zhvillimin e seancave gjyqësore, rezulton se në gjykatat e Kosovës përmbushen mjaftueshëm kërkesat e KEDNj-së dhe jurisprudenca e GjEDNj-së.

Megjithatë, vet mënyra se si aktualisht funksionon ANJF është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe jurisprudencën e GjEDNj. Vendosija e ANJF nën obrellën e Ministrisë së Drejtësisë, nga një institucion i pavarur siç ishte paraprakisht, është në kundërshtim me jurisprudencën e GjEDNj dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. [42]

Me 26 qershor 2024, Ministria e Drejtësisë ka publikuar në platformën e konsultimeve publike Draft Koncept Dokumentin për Ndihmë Juridike Falas. Krahës problemeve të shumta që janë evidentuar në këtë koncept dokument, problematika e politizimit të ANJF -së nuk adresohet fare nga koncept dokumenti[43].

[42] Shih për më tepër: Shala, G. "Politizimi kundër kushtetues i ANJF". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, tetor 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Raporti-Politizimi-kunder-kushtetues-i-ANJF-20.10.2022-1.pdf>).

[43] Shih për më tepër: Rezniciq, A. "Eksperimentimi me ndihmën juridike falas". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, korrik 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/IKD-Eksperimentimi-me-ndihmen-juridike-falas.pdf>).

Mbrojtja e pronës

a. Në procedurë penale

Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj-së e ka garantuar të drejtën në pronë. Sipas këtij neni “çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”. Tutje, ky nen specifikon se “megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

Jurisprudenca e GjEDNj-së në vazhdimësi e ka theksuar faktin se kufizimi i të drejtës së pronës, në kuptim të sekuestrimit apo konfiskimit në procedurë penale, nuk është në kundërshtim me KEDNj-në. Megjithatë, masat e tilla si sekuestrimi apo konfiskimi duhet të ndjekin një interes të përgjithshëm dhe të jenë proporcionale[44].

Me qëllim që sekuestrimi i pasurisë në procedurë penale të jetë në përputhje me KEDNj, Gjykata theksoi se duhet të plotësohen disa kushte. Fillimisht, kërkohet që sekuestrimi të jetë i paraparë me ligj. Përtej kësaj, vendimi për sekuestrim duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë në proporcion me qëllimin e ndjekur. Për të përcaktuar proporcionalitetin e masës në fjalë, sipas GjEDNj-së, duhet të merret parasysh kohëzgjatja e masës së sekuestrimit. Kjo kohëzgjatje, duhet të shqyrtohet ndaras nga kohëzgjatja e gjykimit. Mbajtja në fuqi e një vendimi të sekuestrimit duhet të shqyrtoj domosdoshmërinë e saj në funksion të zhvillimit të procedurës penale, pasojave të zbatimit të saj për të akuzuarin dhe vendimeve të marra nga autoritetet për këtë çështje[45].

Thënë më ndryshe, jurisprudenca e GjEDNj-së specifikon se kohëzgjatja e arsyeshme në kontekst të masës së sekuestrimit është një çështje tjetër nga kohëzgjatja e arsyeshme në kontekst të gjykimit. Kështu, nëse një pasuri është sekuestruar gjatë zhvillimit të gjithë gjykimit në një procedurë penale dhe gjykimi është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm kohor, jo domosdoshmërisht është respektuar edhe arsyeshmëria kohore në raport me masën e sekuestrimit. Kështu, sipas kësaj jurisprudence, gjykatat duhet vazhdimisht ta shqyrtojnë faktin nëse mbajtja e pasurive të caktuara nën masën e sekuestrimit paraqet domosdoshmëri në një procedurë penale, duke pasur parasysh pasojat negative nga të cilat afektohen palët e caktuara.

Në praktikë, monitorimi dhe analizimi ka identifikuar raste kur për qëllime të procedurës penale janë sekuestruar pasuri të ndryshme[1]. Këto pasuri, janë mbajtur nën sekuestrim për vite të tëra, deri kur është nxjerrë një aktgjykim në shkallë të parë. Përgjatë kësaj kohe, ky sekuestrim nuk u rishqyrtua nga Gjykata. Mesatarisht, monitorimi ka gjetur se koha në të cilën pasuritë kanë qëndruar të sekuestruara ishte të paktën 1,272 ditë.

[44] “Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights”. The European Court for Human Rights. Paragraph 167. (See the link: <https://rm.coe.int/court-5282162-v33-case-law-guide-article-6-civil-gts-english-update-31/1680ac8bed>).

[45] See more: Shala, G. “The Unconstitutional Politicization of AFLA”. Kosovo Law Institute. Prishtina, October 2022. (See the link: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Raporti-Politizimi-kunder-kushtetues-i-ANJF-20.10.2022-1.pdf>).

[46] See more: Reznqi, A. “Experimenting with free legal aid”. Kosovo Law Institute. Prishtina, July 2024. (See the link: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/KD-Eksperimentimi-me-ndihmen-juridike-falas.pdf>).

[47] “CASE OF RAIMONDO v. ITALY”. The European Court for Human Rights. Paragraph 27–30. Strasbourg, 22 February 1994. (See the link: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57870>).

[48] “CASE OF LACHIKHINA c. RUSSIE”. The European Court for Human Rights. Page 59. (See the link: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-177865>).

Nga pesë raste të kësaj natyre, në tri (3) prej tyre, aktgjykimi i shkallës së parë nuk i konfiskon pasuritë e sekuestruara gjatë fazës së hetimeve, por obligoi kthimin e tyre. Kështu, pasuritë në fjalë qëndruar të sekuestruara për një kohë, e më pas nuk u konfiskuan nga Gjykata. Situata nuk do të ishte tejet problematike nëse kohëzgjatja e sekuestrimit të aseteve do të ishte e arsyeshme, që nuk është situata në rastin konkret. Këto pasuri, mesatarisht, qëndruan nën masën e sekuestrimit për të paktën 1263 ditë (325 ditë më së paku dhe 1627 ditë më së shumti).

Sa i përket pasurive që janë sekuestruar gjatë fazës së hetimeve, e që me shpalljen e aktgjykimit është obliguar që ato të ju kthehen të të akuzuarve, janë të llojeve të ndryshme. Duke filluar nga telefoni, vetura dhe pasuri të paluajtshme. Përderisa në njërin prej këtyre rasteve është gjetur se pasuri të shumta të paluajtshme kanë mbetur të sekuestruara për pothuajse pesë vite. Në këtë rast, është gjetur se të sekuestruara kanë qenë pothuajse 20 prona të ndryshme të paluajtshme, ku përfshihen banesa, parcela dhe një shtëpi, vlera e të cilave sipas aktakuzës është rreth një (1) milion euro.

Ndërkaq, lidhur me sekuestrimin e pasurisë dhe me problematikat lidhur me këtë çështje u diskutua edhe në fokus grupe. U theksua se nëse janë pretendime që ajo pasuri është objekt i veprës penale, nuk ka se si të lirohet dhe se nëse është përfituar gjatë kryerjes së veprës penale, ajo duhet të konfiskohet. Mirëpo, u tha se ka pasur probleme tek sekuestrimet e pasurive të luajtshme, sidomos veturave, ku u përmenden raste në të cilat vetura të shtrenjta kanë mbetur të sekuestruara për më shumë se 10 vite dhe pamundësia për të kompensuar të pandehurin.

Përderisa, u tha se Kodi i Procedurës Penale ka ndryshuar dhe se prokuroria janë të obliguar të vlerësojnë edhe humbjen e pasurisë ose koston e humbjes së vlerës. Po ashtu, u tha se ligji e jep mundësinë edhe që ato pasuri të shiten dhe mjetet të ruhen deri në përfundim të procedurës. Megjithatë, u theksua se ka çalime në këtë drejtim, por se është duke u bërë progres. Ndërsa, u theksua se ka raste kur janë paditur institucionet për shkak se kanë konfiskuar asete, të cilave ndërkohë u ka humbur vlera. Ndërsa, u përmendën edhe shembuj të sekuestrimit të aseteve përmes vendimeve të Policisë, për të cilin vendim nuk kishin qenë të njoftuar as Gjykata dhe Prokuroria..

b. Në procedurë civile

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, e drejta e pronës mund të cenohet edhe në procedurë civile. Sipas kësaj jurisprudence, kjo e drejtë mund të cenohet në kuptim të kohëzgjatjes së procedurës civile, që cenon gëzimin paqësor të pronës, si dhe përmes kohëzgjatjes së masës së sigurisë.

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, administrimi adekuat i drejtësisë kërkon kohë. Megjithatë, kjo gjykatë thekson se kohëzgjatja e procedurave gjyqësore ka një ndikim të drejtpërdrejt në të drejtën e qytetarëve për gëzim paqësor të pronës, ashtu që tejzgjatja e procedurave gjyqësore u imponon qytetarëve një barrë të tepërt individuale dhe për rrjedhojë prishë ekuilibrin e drejtë që duhet të vendoset ndërmjet të drejtës së qytetarit për gëzimin paqësor të pronave të tij dhe interesit të përgjithshëm[47]. Kështu, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, në këto raste, kohëzgjatja e procedurave cenon të drejtën në pronë[48], pos potencialit që të paraqes shkelje të gjyqimit të drejtë, në kuptim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Siç u tha, monitorimi i realizuar gjënë se kohëzgjatja mesatare e trajtimit të rasteve civile, nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në momentin e nxjerrjes së aktgjyqimit në shkallë të parë është me 1,546 ditë. Kjo problematikë, në kuptim të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, është trajtuar në kapitullin 6 të këtij raporti. Por se, kjo mënyrë e veprimit, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, pos gjyqimit të drejtë, paraqet po ashtu edhe cenim të së drejtës në pronë sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj -së.

Në anën tjetër, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, e drejta e pronës në kuadër të procedurave civile cenohet edhe në kontekst të vendosjes së masës së sigurisë. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, mënyra e aplikimit të masave të sigurisë, përmes të cilave kufizohen të drejtat pronësore deri në një vendimmarrje përfundimtare në procedurë civile, mund të paraqesë shkelje të së drejtës në pronë. Sipas kësaj gjykate, me rastin e aplikimit të këtyre masave, duhet të përmbushen tri kushte thelbësore: 1) masa duhet të jetë e parashikuar me ligj, 2) të ndjekë një qëllim të ligjshëm në interes publik, dhe 3) të respektojë parimin e proporcionalitetit, duke ruajtur një balancë të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale[49].

GJEDNj theksoi se gjykatat duhet të marrin parasysh kohëzgjatjen e masës. Por, përpos kohëzgjatjes, gjykatat duhet ta kenë parasysh edhe përmasën dhe natyrën e kufizimeve të cilat vendosen me masën e sigurisë, si dhe ekzistencën apo mungesën e garancive procedurale. Kështu, në rastet kur masa është zbatuar për një periudhë të konsiderueshme kohore, është e gjerë në përmbajtje, nuk i nënshtrohet shqyrtimit individual dhe aplikohet në mënyrë automatike e rigjide, mund të konstatohet se kemi të bëjmë me një ndërhyrje joproporcionale dhe rrjedhimisht me shkelje të së drejtës në pronë, sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.

[47] "CASE OF KUNIC v. CROATIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-78948>).

[48] "CASE OF IMMOBILIARE SAFFI v. ITALY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 11 janar 2007. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58292>).

[49] "CASE OF KARAHASANOGU v. TURKEY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 121. Strasburg, 16 mars 2021. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-208535>).

Në pesë raste të analizuara, në të cilat gjykatat kishin vendosur masë të sigurisë, IKD gjen se objekt i masës së sigurisë ishin pasuri të paluajtshme. Mesatarisht, kohëzgjatja e masës së sigurisë në këto raste ishte rreth katër vite e gjysmë, apo 1,655 ditë. Në katër raste, në fund të procesit, gjykatat vendosën në favor të palës që ka kërkuar masën e sigurisë derisa në një rast, gjykata vendosi në favor të palës kundërshtare dhe shfuqizuan masën e sigurisë.

Në përgjithësi, kohëzgjatja e masave të sigurisë në këto raste tregon për mos zbatim të standardeve të GjEDNj-së në lidhje me mbrojtjen e pronës me rastin e caktimit të masave të sigurisë në procedurë civile. Veçanërisht, gjetjet tregojnë për mos përputhshmëri në kuptim të kriterit të proporcionalitetit.

Sa i përket masës së sigurisë, gjatë diskutimeve në fokus grup u tha se ajo në çdo kohë mundet të ndryshohet apo revokohet me propozimin e palëve, në rast se kanë ndryshuar rrethanat gjatë udhëheqjes së procedurës. Megjithatë, u tha se në shumicën e rasteve nuk ka propozime të tilla, çka i pamundëson Gjykatës rivlerësimin e masave të sigurisë. Tutje, gjatë fokus grupit u theksua se lëndët civile, në të cilat është vendosur masë e sigurisë, kanë prioritet në trajtim, Megjithatë, trajtimi i atyre rasteve brenda një afati të arsyeshëm pamundësohet për shkak të numrit të madh të rasteve..

Publiciteti i gjykimeve

Publiciteti i seancave gjyqësore është një kompetentë kruciale e të drejtës për një gjykim të drejtë. Për këtë, KEDNJ ka përcaktuar se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj...”[50]. Parimi i publicitetit të gjykimeve përcaktohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, “mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjygjëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribuon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, që nënkupton një gjykim të drejtë”[51]

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, kufizimi i gjykimit për publikun dhe mediat, në rastet e përcaktuara, duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar. Në jurisprudencën e saj, GjEDNJ ka theksuar se “prania e thjeshtë e një informacioni të kualifikuar në shkresat e lëndës nuk nënkupton automatikisht nevojën e mbylljes së gjykimit për publikun, pa vlerësuar domosdoshmërinë për mbylljen e gjykimit, përmes peshimit të parimit që seancat duhet të jenë publike dhe nevojën për të mbrojtur rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Prandaj, para përjashtimit të publikut nga një pjesë e caktuar e procedurës, gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse një përjashtim i tillë është i domosdoshëm në rrethana specifike për të mbrojtur një interes publik, dhe po ashtu duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar”. [52]

[50] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6.1).

[51] “CASE OF MALHOUS v. THE CZECH REPUBLIC”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 55-56. Strasburg, 12 korrik 2001.. (Shih linkun <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-59590>).

[52] “CASE OF NIKOLOVA AND VANDOVA v. BULGARIA”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 74. Strasburg, 17 mars 2014. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-142280%22%7D>).

Në kuptim të mbajtjes së seancave gjyqësore, monitorimi ka evidentuar se gjykatat respektojnë në plotëni parimin e publicitetit të seancave gjyqësore. Të gjitha seancat gjyqësore të monitoruara kanë qenë të hapura për publikun dhe në asnjë prej tyre gjykatat nuk kanë nxjerrë vendime për përjashtimin e publikut nga seancat gjyqësore.

Megjithatë, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, parimi i publicitetit nuk përfshinë vetëm hapjen e seancës gjyqësore por edhe obligimin e gjykatave për njoftimin e mbajtjes së seancave gjyqësore. Në lidhje me këtë, jurisprudenca e GjEDNj-së ka theksuar se “një gjykim përmbush kërkesën për publicitet nëse publiku ka mundësi të marrë informacion për datën dhe vendin e mbajtjes së tij, dhe nëse vendi është lehtësisht i qasshëm për publikun”.^[53]

Në linjë me këtë obligim të gjykatave, monitorimi ka përfshirë edhe njoftimin e gjykatave për mbajtjen e seancave gjyqësore. Nga 100 seanca të monitoruara, vetëm 12 prej tyre janë publikuar në orarin e seancave gjyqësore nga gjykatat. Kështu, obligimi i gjykatave për të njoftuar për mbajtjen e seancave gjyqësore nuk është respektuar në 88% të rasteve të monitoruara ndërsa është respektuar në vetëm 12% të këtyre rasteve.

Për të qenë në linjë me standardet e GjEDNj-së në lidhje me publicitetin e seancave gjyqësore, gjykatat duhet të publikojnë seancat gjyqësore në orarin e seancave. Në të kundërtën, publiciteti që garantojnë gjykatat, në kuptim të standardeve të GjEDNj-së, nuk do të jetë i plotë.

Në kuptim të administrimit të seancave, monitorimi eidenton se mbajtja e seancave gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve vazhdon të mbetet ende një prej problematikave në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kjo gjykatë ka 16 salla të gjyqimit. Ndërkaq, këto salla të gjyqimit gjenden të gjitha në vetëm njërin prej objekteve të gjykatës, objektin “D”. Në këtë objekt gjendet Departamenti Special dhe ai i Krimeve të Rënda. Kurse, në objektin “A”, ku gjendet Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe ai Penal, nuk ka asnjë sallë të gjyqimit dhe pothuajse të gjitha seancat e rasteve që trajtohen nga ky departament, mbahen nëpër zyre të gjyqtarëve.

Kështu, edhe nga monitorimi i 100 seancave gjyqësore, rezulton se vetëm 34 raste seancat janë mbajtur në salla të gjyqimit. Përderisa, këto 34 seanca, kanë qenë të rasteve që trajtohen në Departamentin Special dhe atë të Krimeve të Rënda.

[53] "CASE OF RIEPAN v. AUSTRIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paragrafi 29, Strasburg, 14 nëntor 2000. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-58978"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

Akustika në sallat e gjykimit

Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, i lexuar në tërësi, garanton të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në gjykim. Kjo përfshin, ndër të tjera, jo vetëm të drejtën për të qenë i pranishëm, por edhe për të dëgjuar dhe ndjekur zhvillimet e procedurës. Sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së, akustika e dobët në sallën e gjykimit dhe vështirësitë në dëgjim mund të përbëjnë shkelje të kësaj të drejte, kur e pengojnë të pandehurin të ndjekë dhe të kuptojë procesin në mënyrë efektive[54].

Gjatë monitorimit janë identifikuar dy (2) raste ku në sallat e gjykimit janë evidentuar probleme me akustikën, që kanë vështirësuar dëgjimin e qartë të deklarimeve të bëra gjatë seancës. Vështirësitë akustike në këto raste janë konfirmuara edhe përmes zhvillimit të anketave me palët ndërgjyqëse në këto raste.

Duke theksuar se çështja e akustikës së dobët nuk është evidentuar si problem i përgjithshëm, por vetëm në dy (2) raste specifike, në kuptim të jurisprudencës së GjEDNJ-së, gjyqtarët gjatë seancave gjyqësore kanë për detyrë të sigurohen që të gjitha palët ndërgjyqëse të kenë mundësi të dëgjojnë qartë të gjitha deklaratimet që bëhen në sallë.

Të drejtat gjuhësore

KEDNJ ka përcaktuar se çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën që të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë[55]. E drejta e të pandehurit në përkthim është një parakusht i nënkuptuar për zhvillimin e gjykimit të drejtë. Asnjë person nuk ka mundësi që të gëzojë gjykim të drejtë nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi. Në mungesë të përkthimit, aftësia e të akuzuarit për të marrë vendime, për të cilat është i informuar, gjatë procedurës mund të vihet seriozisht në dyshim[56].

Në lidhje me të drejtën në përkthim, GjEDNJ ka theksuar se është obligim i gjykatave që të verifikojnë nëse drejtësia e gjykimit kërkon, apo ka kërkuar, caktimin e një përkthyesi për të ndihmuar të pandehurin. Sipas GjEDNJ-së, ky detyrim nuk kufizohet vetëm në situatat kur i pandehuri i huaj paraqet në mënyrë eksplicite kërkesë për përkthim, ashtu që duke pasur parasysh vendin qendror që zë e drejta për një gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike, sipas GjEDNJ-së, ky detyrim lind sa herë që ekzistojnë arsye për të dyshuar se i pandehuri nuk zotëron njohuri të mjaftueshme në gjuhën e procedurës, për shembull nëse ai apo ajo nuk është as shtetas e as banor i shtetit ku po zhvillohen procedurat. Ky detyrim, sipas GjEDNJ-së, lind po ashtu edhe kur parashihet që përkthimi të bëhet në një gjuhë të tretë (Shembull: Kur nuk gjendet përkthyes për gjuhën armëtarë të të pandehurit, por se i pandehuri njeh edhe një gjuhë tjetër jo armëtarë të tij, e cila nuk është gjuhë zyrtare e gjykatës).[57]

[54] STANFORD v. THE UNITED KINGDOM par 26 dhe 29

[55] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këshilli i Evropës. Neni 6.3 (e). Romë, 4 nëntor 1950. (Shih linkun: https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf).

[56] "CASE OF BAYTAR v. TURKEY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 50 dhe 54–55. Strasburg, 14 prill 2015. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-147468>).

[57] Shembull: I.

Në rrethana të tilla, Gjykata duhet të vlerësojë njohuritë e të pandehurit në gjuhën e tretë dhe ky vlerësim duhet të bëhet para se të merret vendimi për ta përdorur atë gjuhë për qëllime të përkthimit[58].

INë anën tjetër, duhet theksuar faktin se KEDNJ, të drejtës në përkthim i referohet vetëm në kontekst të procedurës penale. Megjithatë, është e nënkuptueshme se nuk mund të ketë gjykim të drejtë as në procedurë civile, nëse ndonjëra palë ndërgjyqëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura para gjykatës.

Legjislacioni kosovar në lidhje me të drejtën në përkthim të palëve ndërgjyqëse të cilët nuk e kuptojnë gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore është në përputhje me KEDNJ-në dhe jurisprudencën e GjEDNJ-së. Në lidhje me procedurat penale, Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale ka përcaktuar se “personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Përkthimi duhet të jetë i cilësisë së mjaftueshme për të garantuar paanshmërinë e procedurës dhe sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur”. [59]

Ndërkaq, në raport me procedurat civile, Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore ka përcaktuar se “në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojari në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtresave dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrohet në seancë gjyqësore”. Sipas këtij ligji, “shpenzimet e përkthimit mbeten në ngarkim të buxhetit të gjykatës”. [60]

Të drejtën e përkthimit e kanë përforcuar maksimalisht Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale dhe Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Kjo duke e cilësuar mos respektimin e kësaj të drejte si shkelje esenciale apo thelbësore të procedurës[61], ashtu që vendimet gjyqësore të cilat janë nxjerrë në mos respektim të kësaj të drejte duhet të anulohet domosdoshmërisht.

Përtej aspektit ligjor, monitorimi ka gjetur se këto të drejta respektohet edhe në praktikë. Nga të gjitha rastet e monitoruara, rezulton se në vetëm katër (4) raste seanca nuk është zhvilluar në gjuhën që e kuptojnë të gjitha palët në procedurë. Tri (3) prej këtyre rasteve janë penale dhe një tjetër është rast civil. Në të gjitha këto raste, monitorimi ka gjetur se Gjykata ka siguruar përkthim adekuat.

Kështu, në raport me të drejtat gjuhësore të palëve në procedurë, sikurse ligji ashtu edhe praktika gjyqësore është në harmoni me KEDNJ dhe jurisprudencën e GjEDNJ.

[58] “CASE OF VIZGIRDA v. SLOVENIA”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 81. Strasburg. (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-185306>).

[59] Neni 14.2. Kodi Nr. 08/L-032 për Procedurën Penale. Republika e Kosovës, 2022.

[60] Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Neni 96. Republika e Kosovës, 2008.

[61] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale. Neni 384.1.1.4.. Republika e Kosovës, 2022; Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Neni 182.2.j. Republika e Kosovës, 2008.

Vendimmarrja e institucioneve të pavarura

Sif u tha, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, referencë në mënyrën e interpretimit të të drejtave të njeriut është jurisprudenca e GjEDNj-së. Kjo në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës, që përcakton se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk i referohet vetëm një institucioni të caktuar, për shembull gjykatave, por i referohet rendit juridik kosovar. Kjo nënkupton se obligimi për të interpretuar të drejtat e njeriut në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së nuk është obligim vetëm i gjykatave, por i të gjitha institucioneve publike me rastin e marrjes së vendimeve të caktuara.

Monitorimi i zhvilluar, përpos gjykatave, ka përfshirë edhe pesë institucione të pavarura, në vendimet e të cilave është analizuar niveli i aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së. Këtu bëjnë pjesë AIP, KPMSHCK, KPM, OShP dhe AK.

Nga analizimi i 60 vendimeve të pesë institucioneve të pavarura, monitorimi gjenë se jurisprudenca e GjEDNj-së është aplikuar në vetëm katër (4) vendime, të nxjerra nga vetëm dy (2) institucione. Tri (3) prej rasteve kur është aplikuar jurisprudenca e GjEDNj-së janë vendime të marra nga AIP. Në dy (2) prej këtyre rasteve përmenden vendime specifike të GjEDNj-së, kurse në rastin tjetër, jurisprudenca e kësaj Gjykate përmendet vetëm përgjithësisht. Rast tjetër i identifikuar i aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së është një (1) vendim i KPMSHCK-së, në të cilin jurisprudenca e GjEDNj-së është përmendur vetëm në përgjithësi dhe nuk është saktësuar ndonjë vendim specifik i kësaj Gjykate. Ndërkaq, tek tri (3) institucionet tjera që ishin pjesë e këtij monitorimi, përkatësisht KPM, OShP dhe AK, nuk është evidentuar asnjë vendimin, arsyetimi i të cilit përfshinë jurisprudencën e GjEDNj-së.

[65] Criminal Procedure Code No. 08/L-032. Article 384.1.1.4. Republic of Kosovo, 2022; Law No. 03/L-006 on Contested Procedure. Article 182.2.j. Republic of Kosovo, 2008.

Institucioni	Vendime të analizuara	Vendime që përmendin GjEDNj	Përqindja e zbatimit (%)	Cilësia e zbatimit
AIP	12	3	25%	2 vendime me referenca specifike të GjEDNj-së, 1 vendim vetëm në mënyrë të përgjithshme
KPMShCK	12	1	8.30%	Jurisprudenca e GjEDNj-së përmendet vetëm në mënyrë të përgjithshme, pa referencë specifike
KPM	12	0	0%	Nuk përmendet jurisprudenca e GjEDNj-së
OShP	12	0	0%	Nuk përmendet jurisprudenca e GjEDNj-së
AK	12	0	0%	Nuk përmendet jurisprudenca e GjEDNj-së
TOTAL	60	4	6.70%	Vetëm 2 nga 5 institucione kanë zbatuar jurisprudencën e GjEDNj-së në gjithsej 4 vendime

Tabela 2: Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nga institucionet e pavarura.

Këto gjetje flasin për një mos aplikim të gjerë të jurisprudencës së GjEDNj-së në vendimet e këtyre institucioneve të pavarura. Përfundimisht tri (3) vendimeve të AIP-it dhe një (1) vendimi të KPMShCK-së, monitorimi nuk evidentoi raste të aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në vendimet e tri (3) institucioneve të tjera të pavarura.

Në këtë drejtim, duhet ripërsëritur faktin se jurisprudenca e GjEDNj-së është obligative për të gjitha institucionet publike. Kështu, institucionet që ishin pjesë e këtij monitorimi, duhet ta kenë parasysh faktin se vendimmarrja e tyre përfshinë çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, interpretimi i të cilave duhet të bëhet në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së. Për këtë arsye, këto institucione duhet të fillojnë të veprojnë në përputhje me obligimin e tyre kushtetues, duke aplikuar jurisprudencën e GjEDNj-së në vendimet e tyre.

Prezumimi i pafajësisë

KEDNJ ka përcaktuar se “çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.[62] Parimi i prezumimit të pafajësisë është garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale.

Sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së, parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që, ndër të tjera, Gjykatat nuk duhet të fillojnë shqyrtimin e çështjes me idenë e paramenduar se i pandehuri është kryerës i veprës penale[63]. Gjatë zhvillimit të monitorimit, nuk është evidentuar ndonjë sjellje e gjyqtarëve që mund të konsiderohet se, në përputhje me jurisprudencën e GjEDNJ-së, do të paraqiste shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë në këtë kontekst.

Në anën tjetër, duhet theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk paraqet detyrim vetëm në raport me gjyqtarët. Detyrimi i respektimit të këtij parimi shtrihet edhe në raport me zyrtarët e tjerë publik. Si një garanci procedurale e procesit penal, prezumimi i pafajësisë vendos kërkesat e veta në rastet, ku ndër të tjera, përfshihen edhe shprehjet e parakohshme mbi fajin e të akuzuarit, nga zyrtarët publikë[64], duke përfshirë edhe vetëm një pasqyrim në arsyetim të vendimit rreth asaj se i akuzuari mund të jetë fajtor[65].

Kështu, praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ndalon gjykimin publik të bërë nga zyrtarët dhe autoritetet publike ndaj individëve të liruar sipas një procedure gjyqësore dhe vendimi përfundimtar gjyqësor, pavarësisht vlerësimit meritot të gjykatës mbi rastin konkret.

Udhëzuesi i GJEDNJ-së mbi të drejtën në gjykim të drejtë, i siguron një vend të veçantë situatave lidhur me deklaratat e zyrtarëve publikë, përkatësisht atyre të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ për shkak të prezencës së lartë në publik.[66]

Sikurse në vitet paraprake[67], edhe gjatë vitit 2024 dhe vitit 2025, ka pasur deklaratat të ndryshme nga përfaqësues të Qeverisë dhe Kuvendit, të cilat kanë ndërhyrë në punën e sistemit të drejtësisë, derisa në raport me të pandehurit, kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë.[68] Deklarime të tilla nga akterët institucional, siç është thënë edhe në të kaluarën, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe jurisprudencën e GjEDNJ-së.

[62] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6.2.

[63] "CASE OF BARBERÀ, MESSEGUÉ AND JABARDO v. SPAIN". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 6 dhjetor 1988. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57429"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[64] "CASE OF ALLENET DE RIBEMONT v. FRANCE". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët 35-36. Strasburg, 10 shkurt 1995. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57914"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)); "CASE OF NEŠŤÁK v. SLOVAKIA". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 88. Strasburg, 27 shkurt 2007. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-79608"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[65] "CASE OF CLEVE v. GERMANY". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 41. Strasburg, 15 janar 2015. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-150309"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

[66] "Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Faqe 72-73. Përditësuar më 31 gusht 2022. (Shih linkun: https://icct.nl/sites/default/files/import/publication/guide_art_6_criminal_eng.pdf).

[67] Jakaj, N. dhe Zekaj, E. "Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike". Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Nderhyrjet-ne-sistemin-e-drejtësisë-permes-deklaratave-publike-1-1.pdf>).

[68] Shih psh. "Kurti flet për Enver Sekiragën: Arratisja e tij është dështim i sistemit tonë gjyqësor". Nacionale. (Shih linkun: <https://nacionale.com/politike/kurti-flet-per-enver-sekiragen-arratisja-e-tij-eshte-deshtim-i-sistemit-tone-gjyqesor/>); "Kurti kritikon Prokurorinë e Shtetit: Kemi hyrë në javën e 30-të nga sulmi në Banjë dhe ende s'ka aktakuzë për Radoiqin". Reporteri. 14 prill 2024. (Shih linkun: <https://reporteri.net/lajme/kurti-kritikon-prokurorine-e-shtetit-kemi-hyre-ne-javen-e-30-te-nga-sulmi-ne-banjske-dhe-ende-ska-aktakuze-per-radoiqin>); <https://nacionale.com/politike/kurti-flet-per-enver-sekiragen-arratisja-e-tij-eshte-deshtim-i-sistemit-tone-gjyqesor/>); ""Pesë vjet pa rezultat", Kurti sërish me kritika për Prokurorinë Speciale: Kemi rritur buxhetin, sillni kriminelët para drejtësisë". Dosja. 31 maj 2024. (Shih linkun: <https://dosja.al/bota/pese-vjet-pa-rezultat-kurti-kritikon-serish-prokurorine-speciale-kemi-rritu-i374577>).

Përfundime

- Gjetjet e monitorimit evidentojnë një nivel të ulët të aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në vendimet e gjykatave. Kjo mënyrë e veprimit paraqet mos përmbushje të obligimit kushtetues të gjykatave sipas nenit 53 të Kushtetutës.
- Monitorimi evidentoj se në disa raste, jurisprudenca e GjEDNj-së u aplikua vetëm formalisht, duke mos pasur referim në vendime specifike të kësaj Gjykate.
- Në vetëm 2 % të seancave të monitoruara u përmend jurisprudencë e GjEDNj-së në mënyrë të përgjithësuar, pa specifikuar vendime të kësaj Gjykate.
- Jurisprudenca e GjEDNj-së u aplikua në 13 % të aktgjykimeve të analizuar: në 8,5 % të tyre u cituan vendime specifike të Gjykatës, ndërsa në 4,5 % ajo u përmend vetëm në mënyrë të përgjithshme, pa një referencë specifike.
- Përqindja më e lartë e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së është në aktgjykimet civile (18.7 %), pasuar me aktgjykimet e natyrës administrative (10 %). Përqindja më e ulët e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së, për nga natyra e rasteve, evidentohej tek aktgjykimet penale.
- Për nga niveli i gjykatave, niveli më i lartë i aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së, evidentohej tek gjykatat themelore (21 %), pasuar nga Gjykata Supreme me 8%. Në Gjykatën e Apelit, evidentohej vetëm 2% të aktgjykimeve në të cilat është aplikuar jurisprudenca e GjEDNj-së.
- Nuk u evidentua asnjë rast kur avokatët aplikuan jurisprudencën e GjEDNj-së në parashtrësit e tyre. Duke pasur parasysh se obligimi për aplikim të jurisprudencës së GjEDNj-së bie mbi gjykatat dhe jo avokatët, aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së nga avokatët do të shtynte Gjykatën të vlerësonte pretendimet nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së, si dhe do të rriste efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave të palëve që përfaqësohen nga avokatët.
- Analiza e vendimeve të pesë institucioneve të pavarura tregon pothuajse mungesë totale të aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj-së. Vetëm 4 vendime (6,7 %) përfshijnë ndonjë referencë në jurisprudencën e GjEDNj-së, dhe ato vijnë nga vetëm dy institucione (tri nga AIP, dy me citime specifike, një referencë të përgjithshme dhe një vendim i KPMSHCK-së me referencë të përgjithshme). Monitorimi nuk evidentoj asnjë rast kur jurisprudenca e GjEDNj-së u aplikua në ndonjë nga vendimet e analizuar të KPM, OShP dhe AK. Kjo situatë flet për një mos përmbushje të hapur të obligimit kushtetues nga këto institucione.
- Monitorimi gjen se, në parim, gjyqësori nuk respekton të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Mesatarja e përgjithshme e trajtimit të lëndëve gjyqësore është 1.256 ditë. Në çështjet civile, kjo mesatare është 1.546 ditë, në çështjet penale 1.211 ditë ndërsa në rastet administrative 788 ditë.
- Rasti më i vjetër penal i evidentuar gjatë monitorimit ishte një rast i vitit 2006. Po ashtu, rast i vitit 2006 ishte edhe një rast civil. Ndërsa, rasti më i vjetër në procedurë administrative ishte një rast i iniciuar në vitin 2015.

- Gjetjet dëshmojnë se gjyqësori nuk është i aftë të ofroj gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe për këtë përgjegjësia nuk bie vetëm mbi sistemin gjyqësor.
 - Vështirësitë e gjyqësorit për të ofruar gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor janë krijuar si rezultat i numrit të madh të lëndëve të pranuar, që pothuajse kanë trefishuar numrin e lëndëve të pazgjidhura, përkundër katërfishimit të numrit të lëndëve të zgjidhura nga gjyqësori.
 - Kosovës i mungon një mekanizëm për adresimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Projektligji i MD-së që tentonte ta bëjë këtë ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe rrezikonte të cenonte seriozisht administrimin e drejtësisë në gjykata.
 - Sa i përket standarde të jurisprudencës së GjEDNj-së në lidhje me respektimin e barazisë së armëve në kontekst të administrimit të provave, gjetjet e monitorimit dëshmojnë se në përgjithësi, me disa përjashtime, mënyra e administrimit të provave është në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së.
 - Sipas KEDNj-së, jurisprudencës së GjEDNj-së dhe legjislacionit pozitiv, gjykatat janë të obliguara që të japin arsyetim në lidhje me pretendimet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. e arsyetuara kanë për qëllim t'u tregojnë palëve se janë dëgjuar.
1. Në rrafshin praktik, monitorimi evidenton mangësi në këtë fushë, ashtu që në rastet e analizuara, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë përgjigje në gjithsej 48.4% të pretendimeve të ngritura. Madje, në vendimet e saj, përkritazi me pretendimet për të cilat nuk është dhënë arsye, Gjykata e Apelit nuk ka treguar nëse këto pretendime janë apo jo vendimtare.
 2. Në disa raste, GJK ka evidentuar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, për shkak të mos dhënies së arsyetimit në vendimet gjyqësore.
- Sa i përket ndihmës profesionale ligjore (përket ndihmës juridike falas), monitorimi gjen se palët ndërgjyqëse pothuajse në të gjitha rastet kishin përfaqësim profesional nga një avokat. Kështu, në raport me zhvillimin e seancave gjyqësore, rezulton se në gjykatat e Kosovës përmbushen mjaftueshëm kërkesat e KEDNj-së dhe jurisprudenca e GjEDNj-së.
 - Megjithatë, sa i përket ndihmës juridike falas, vet mënyra se si aktualisht funksionon ANJF është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe jurisprudencën e GjEDNj-së.
 - Monitorimi ka evidentuar një respektim të plotë të parimit të publicitetit të seancave gjyqësore, në kuptim të mbajtjes së seancave gjyqësore.
 - Parimi i publicitetit të seancave gjyqësore është cenuar me rastin e mos njoftimit të gjykatave për këto seanca, përkatësisht mos publikimit të seancave gjyqësore në orarin e seancave.
 - Publiciteti dhe administrimit i drejtësisë në disa raste cenohet për shkak të mbajtjes së seancave gjyqësore në zyre të gjykatësve dhe jo në sallatë të gjyqimit.
 - Monitorimi evidentoi se në disa raste mund të ngritën dyshime se akustika në sallën e gjyqimit cenon standardet e përcaktuara nga GjEDNj.

- Sekuestrimi i pasurisë në procedurë penale, ashtu siç zbatohet aktualisht, nuk përmbush standardet e GjEDNj-së për proporcionalitet dhe kontroll periodik. Në pesë rastet e monitoruara pasuritë mbetën të sekuestruara mesatarisht 1 263 ditë, pa u rishqyrtuar nga gjykata, dhe në tri prej tyre u urdhërua kthimi i pasurisë pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë.
- Monitorimi ka evidentuar se proporcionaliteti cenohet edhe në rastet e masave të sigurisë nga aseteteve të caktuara, të cilat vendosen gjatë një procedure civile.
- Kohëzgjatja mesatare prej 1 546 ditësh, gati 4 vjet nga padia deri te aktgjykimi i shkallës së parë në çështjet civile, tregon se sistemi gjyqësor po ua imponon palëve një barrë të tepërt. Në dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së, një vonesë e tillë jo vetëm që cenon të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (neni 6.1 KEDNj), por edhe minon gëzimin paqësor të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNj-së).
- Monitorimi ka evidentuar se gjykatat kanë respektuar në plotëni të drejtat gjuhësore të palëve në procedurë.
- Monitorimi nuk evidentoi raste të cenimit të parimit të barazisë së armëve nga ana e gjykatave. Megjithatë, monitorimi evidentoi cenim të këtij parimi nga akterët politik, përmes deklaratave ndërhyrëse ndaj sistemit të drejtësisë.

Rekomandime

- Gjyqtarët, në përputhje me obligimin kushtetues, të ngritin nivelin e aplikimit të jurisprudencës së GjEDNj në aktgjykimet e tyre.
- Avokatët, në kontekst të argumentimit të pretendimeve të tyre, të aplikojnë jurisprudencën e GjEDNj.
- Jurisprudenca e GjEDNj të aplikohet nëpërmjet rasteve specifike dhe jo vetëm në mënyrë abstrakte.
- Institucionet e pavarura të aplikojnë jurisprudencën e GjEDNj në vendimet që nxjerrin.
- Gjykatat të prioritojnë zgjidhjen e rasteve të vjetra.
- Institucionet e administratës publike dhe Kuvendi të përmbushin obligimet ligjore, duke parandaluar vërshimin e vazhdueshëm të gjyqësorit me lëndë.
- Të themelohet mekanizmi për adresimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Ligji që themelon këtë mekanizëm të jetë në përputhje me Kushtetutën, KEDNj dhe jurisprudencën e GjEDNj si dhe tu përgjigjet specifikave që ka sistemi gjyqësor kosovar.
- Gjykata e Apelit të japë përgjigje në të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga palët ndërgjyqëse.
- Qeveria dhe Kuvendi të miratojnë Ligjin që kthen ANJF në institucion të pavarur nga MD.
- Gjyqtarët të publikojnë seancat në orarin e gjykatës.
- Në çdo rast kur është e mundur, seancat të mbahen në sallat e gjykimit dhe jo në zyrat e gjyqtarëve.
- Gjyqtarët të kujdesen për akustikën në sallat e gjykimeve, duke u siguruar që të gjitha palët ndërgjyqëse të dëgjojnë në mënyrë adekuate zhvillimin e seancës gjyqësore.
- Gjyqtarët, brenda kompetencave që kanë, të kujdesen për mbrojtjen e pronës së palëve, pasuria e të cilave vihet nën sekuestrim apo nën masë të sigurisë.
- Zyrtarët politik mos të përfshihen në deklarata sulmuese ndaj sistemit të drejtësisë.

